

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i përgjithshëm, me gjyqtarene vetme gjykuese Lumnije Krasniqi, me zyrtarin ligjor Leutrim Hoti, në çështjen penale, kundër të pandehurit **S.I.**, për shkak të veprës penale Kanosje nga neni 185 par.2 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.6795/14, të dt.01.02.2016, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, për dhënien e urdhrin ndëshkimor PP.II.nr.6795/14, të dt.01.02.2016, më dt.**02.06.2017**, jashtë seancës, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.6795/14, të dt.01.02.2016 dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMORË

I pandehuri: S.I., nga i ati S., i lindur me ..., në P. tani me vendbanim në fshatin K., ku edhe jeton, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal:

ËSHTË FAJTORË

S e p s e:

Sepse me datë 11.09.2015 rreth orës 14:30, i pandehuri me përmjet telefonit të tij e ka thirrur të dëmtuarin Sh.U., në lidhje me një borxh të mëhershëm dhe në bisedë e sipër i akuzuari e ka kanosur seriozisht me fjalët “ose bimi jo 1000 € por 30.000 € ose kam me ti mbyjt fëmijët” me ç ‘rast tek i dëmtuari ka shkaktuar frikë dhe ankth.

- me këtë ka kryer veprën penale Kanosje nga neni 185 par.2 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 41, 43, 46, të KPRK, si dhe neneve 365 e 495, të KPPRK-së, të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej **250 (dyqindpesëdhjetë euro) €**, të cilin dënim, është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata të njëjtin do ta ekzekutoj duke i caktuar nga një ditë burgimi për 20 (njëzet)€ të gjobës.

I pandehuri obligohet të paguaj shpenzimet e procedurës penale në emër të paushallit gjyqësorë në shumën prej **20 (njëzet) €**, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari Sh.U., rr “E.H.” p/n P., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i përgjithshëm, me Aktakuzën PP.II.nr.6795/14, të dt.01.02.2016, e ka akuzuar **S.I.n**, për shkak të veprës penale Kanosje nga neni 185 par.2 të KPRK-së, dhe njëherësh, nga gjykata ka kërkuar dhënien e urdhrin ndëshkimorë, me arsyetimin së ka prova të besueshme nga kallëzimi penal, lidhur me arsyeshmërinë e akuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve, se i pandehuri vërtetë e ka kryer veprën penale, për të cilën akuzohet.

Gjyqtarja e vetme gjykuese, me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, konform nenit 493, të KPPRK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495, të KPPRK, dhe pranoi kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kjo gjykatë, pas vlerësimit të gjitha provave materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës dhe atë: kallëzimi penal nr. 2014-AB-3167, i datës: 23.09.2014, procesverbali mbi intervistimin e të dëmtuarit i datës: 11.09.2014 dhe shkresat tjera të lëndës, vërtetoi gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe konstatoi se këto janë prova të besueshme mbi bazën e të cilës vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Duke u bazuar në këto që u ceken me lartë, gjykata konstaton se i pandehuri S.I., është penalisht përgjegjës për kryerjen e veprës penale Kanosje nga neni 185 par.2 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë elementet e kësaj vepre penale.

Me rastin e shqyrtimit të dënimit ndaj të pandehurit, gjykata i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit sipas nenit 73 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të paushallit gjyqësorë, është marr në bazë të nenit 450 par.2 pika 2.6 të KPPK-së.

Në bazë të nenit 463, par. 1 dhe 2, të KPP-së, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 365 e 495, të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.923/16, i dt.02.06.2017

Zyrtari Ligjor,
Leutrim Hoti

Gjyqtarja,
Lumnije Krasniqi

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, i pandehuri apo mbrojtësi i tij mund të paraqesin kundërshtim në afatin prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të tij, në këtë gjykatë.